KËRKESË
Nr. 240/12, datë 27.2.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për një ndryshim në VKM-në nr. 61, datë 29.1.2025, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i fiderave me kabëll 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias'"', me vlerë totale paraprake 130 920 (njëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *Group* sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

a) Vlerësimi i pasurisë së llojit "arë" është llogaritur bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 41/2019, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. dhe KfW-së, *Frankfurt AM Main*, për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I", për financimin e projektit: "Ndërtimi i fiderave me kabëll 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias". Raporti i vlerësimit nga ekspertët e kontraktuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *Group* sh.a dhe miratuar nga banka e KfW-së, si më poshtë vijon.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, tek Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *Group* sh.a, si dhe tek Agjencia Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 130 920 (njëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I FIDERAVE ME KABËLL 20 kV, V4, V5 DHE KABINAVE TË REJA NGA NËNSTACIONI I RI VALIAS"

Nr.	Nr. i shtyllës	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimet për shpronësim					Shënime *(kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë, etj.)*
												"Arë"/ "truall"					
		Emër	Atësia	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Vlera e drutorëve (lekë)	Vlera totale (lekë)	
1	K2/V4	Luan	Hysni	Mërkuri	Valias	1649	18/23	Are	3785.2	18	187	24	5455	130920		130920	
VLERA PARAPRAKE																130920	